




INFORMATA PËR COVID-19




0 Lani duart me ujë të rrjedhshëm




1 aplikoni sapun të mjaftueshëm për të mbuluar të gjithë sipërfaqen e duarve




2 fërkoni duart pëllëmbë me pëllëmbë




3 pëllëmbën e dorës së djathtë fërkoni pjesën prapa të dorës së majtë me gishtrinjtë të gërshetuar dhe anasjelltas




4 pëllëmbë me pëllëmbë me gishta të gërshetuar




5 pjesët e pasme të gishtërinyje me anën e kundërt të pëllëmbës me gishtërinyjtë të ndërlidhur



6 fërkimi rrotullues i gishtit të majtë të mbërthyer në pëllëmbën e djathtë dhe anasjelltas




7 fërkim rrotullues, para dhe prapa me gishta të kapur të dorës së djathtë në pëllëmbën e majtë dhe anasjelltas




8 shpërlaj duart me ujë të rrjedhshëm




9 thani duart tërësisht me një peshqir për një përdorim



10 përdoreni peshqirin për të ndaluar ujin



11 ... dhe duart tuaja janë të sigurta.



COVID 19

është sëmundje e shkaktuar nga koronavirusi (SARS-COV2) raportuar në dhjetor të vitit 2019

NGA VIRUSI MUND TË INFEKTOHET ÇDO NJERI!

Përkrahur nga OBSH, Zyra në Prishtinë, përmes fondeve të Ambasadës Britaneze, përmes instrumentit MPTF - Fondit të Partneritetit Shumëpalësh!

COVID-19 përhapet përmes:

Spërklave të pështymës gjatë kollitjes apo tështimës

Prandaj

- Mbani maskat gjatë gjithë kohës derisa jeni në ambiente të brendshme dhe të jashtme të shkollës
- Mbuloni gojën dhe hundën me maskë
- Kur kolliteni ose teshtini mbuloni gojën me faculetë ose me mëngë të parakrahu
- Faculetat e përdorura hudhni në një shportë të mbyllur.



Kontaktit të afërt personal si prekja, përçafimi, dhënia e dorës

Prandaj

- Respektoni distancën fizike, distancën minimale prej 1.5 metër
- Shmangni grumbullimet gjatë pushimit
- Mos e përçafoni shoqen dhe shokun në shkollë
- Mos u përshëndetni me duar.



Përmes kontaktit me sipërfaqe dhe gjësende të kontaminuara

Prandaj

- Lani duart shpesh me sapun dhe ujë të rrjedhshëm së paku 20 sekonda ose dezinfektoni me dezinfektues me baze alkooli
- Thani duart me një leckë të pastër ose me një peshqir personal
- Mos i prekni me duar sytë, gojën dhe hundën.



Cilat janë shenjat e një personi të infektuar me koronavirus?

- lodhje
- ethe
- temperaturë
- kollë
- dhimbje të shpinës
- dhimbje të kokës,
- humbje të shijës dhe
- vështirësi në frymëmarrje.



Nëse JU keni ndonjë nga këto shenja, atëherë Ju duhet të qëndroni në shtëpi / të izoloheni dhe të kërkoni këshilla mjekësore në Qendrat më të afërt të mjekësisë familjare. Nëse ndonjë familjar i juaji është identifikuar me COVID-19, ju duhet të qëndroni në shtëpi.

Në të gjitha ambientet e shkollës menaxhmenti i shkollës duhet të sigurojë vazhdimisht sasi të mjaftueshme të: ujit të rrjedhshëm, sapuna të lëngshëm, letra për fshirje të duarve dhe dezinfektues me përbajtje alkooli 70%.



Të gjitha hapësirat e shkollës duhet të mirëmbahen rregullisht. Ato duhet të pastrohen fillimisht e pastaj të dezinfektohen. Largimi i mbeturinave nga ambientet e mbyllura dhe të hapura është proces që duhet të bëhet çdo ditë për ta mbrojtur ambientin e shkollës.

Bëhuni të përgjegjshëm për shëndetin e Juaj dhe të të tjerëve! TA RUAJMË BASHKË SHËNDETIN!